



Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

01Nr 06-27864 /2019

Klinë, 31. 05. 2019

EKSTRAT-PROCESVERBAL

I Seancës së V-të, të rregullt, të punës së Kuvendit të Komunës së Klinës, mbajtur më 31. 05. 2019, filluar në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi I Kuvendit të Komunës së Klinës, z. Fadil Gashi, I filloi punimet e seancës duke përshëndetur kryetarin e Komunës, z. Elezaj, nënkryetarin, z. Hoti, anëtarët e Kuvendit, përfaqësuesit e OSBE, KFOR, OJQ, komandantin e Policisë, drejtorët e Drejtorive si dhe gjithë të pranishmit. Z. Gashi para se ta prezantoi Rendin e Ditës, konstatoi se prezent në këtë seancë janë 25 anëtarë si dhe sipas informacioneve që ai ka, do të jenë prezent edhe dy anëtarët që për momentin mungojnë, Besart Hoti dhe Elvira Sejdiu. Për rendin e ditës, z. Gashi, bëri një propozim për një pikë të re. " Në bashkëpunim të Kryetarit të Komunës me Policinë, drejtorinë e inspektoratit, prokurorinë, është iniciuar ndryshimi dhe plotësimi I rregullores për orarin e fillimit dhe mbarimit të orarit të punës së bizneseve në Komunën e Klinës. Brenda këtij iniciimi të ndryshimeve janë dy vendime. Një për themelimin e Komisionit për fillimin e ndryshimit të kësaj rregulloreje dhe e dyta është një propozim-vendim, që deri në miratimin e rregullores kërkohet që të pezullohet neni 10, paragrafi 1. Dhe 2. Pra, kjo është pika shtesë e propozuar. Një pikë me tre vendime." - theksoi z. Gashi, në fjalën e tij për arsyeshmerinë e propozimit për pikë të re shtesë në Rendin e ditës. Kryesuesi në vazhdim, hap debat për Rendin e Ditës.

z. Enver Berisha: Përshëndetje për të gjithë. E konsideroi krejt normale iniciimin për ndryshimin e rregullores për ndryshimin e orarit të punës së bizneseve por nuk mund të pajtohem që ne sot të marrim vendim që të pezullojmë nenin 10 bashkë me dy paragrafët, pasi që nuk shoh asnjë arsye emergjente për të bërë këtë pezullim sot. Ne si grup Kuvendar e mbështesim iniciimin e ndryshimeve të rregullores në fjalë por nuk e mbështesim miratimin e vendimeve për pezullim të neni 10, pasi që konsiderojmë që duhet analizuar dhe shqyrtuar më në detaje dhe nuk shohim nevojë për nxitim.

z. Fadil Gashi, kryesues: Mendoj që ta fusim në rend dite propozimin dhe kur të vijmë tek kjo pikë, atëherë e debatojmë dhe mund ti ndajmë dhe miratojmë veç e veç. Kush është PËR këtë Rend Dite me këtë pikë shtesë të propozuar?

Rendi I Ditës u MIRATUA me 25 vota PËR, asnjë Kundër dhe asnjë abstenim.

RENDI I DITËS:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Pyetje dhe përgjigje,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për faljen e pjesshme të borxheve-qeras komunale për rastet e banimit sociale me kushtëzim (ref.Drejtoria e FEZH),
5. Pezullimi i dy vendimeve të miratuara nga Kuvendi i Komunës Klinë:
 - a. Vendimit 01nr.06-9089/2019 të datës 05.03.2019 lidhur me ngastrën nr.66/4 në ZK-Dresnik-Komuna Klinë (ref.Drejt.UMM),
 - b. Vendimit 01nr.06-9086/2019 të datës 05.03.2019 lidhur me ngastrën nr.515/4 dhe 515/6 ZK-Klinë (ref.Drejt.UMM),
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Klinës 2019-2023 (Kryesuesi i Grupit punues),
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për Formimin e Komisionit vlerësues-ad hoc për ndarjen e titullit “Nderi i Qytetit” në Komunën e Klinës,
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozimit për Formimin e Komisionit vlerësues-ad hoc për ndarje të bursave për studentet e Komunës së Klinës (ref.drejtoria e Arsimit).

Pika 1. E Rendit të Ditës: Arsyetimi i Mungesave.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi, theksoi se në lidhje me mungesat e bëri arsyetimin që në hyrje të rendit të ditës, prandaj kërkon që të kalohet në pikën e dytë.

Pika 2. E Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

Meqenëse nuk kishte askush nga anëtarët e Kuvendit asnjë vërejtje dhe as për të shtuar në lidhje me procesverbalin e seancës së kaluar, kryesuesi e vënë në miratim dhe me 25 vota PËR, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, MIRATOHET.

Pika 3. e Rendit të Ditës: Pyetje dhe përgjigje.

z. Esat Raci: Përshëndetje për të gjithë. Edhe pse nuk është kryetari prezent, dëshiroi që të informohem për gjendjen e ujit të pijes në Komunën tonë. Kush mund të më jap një informacion për këtë?

z. Ibër Elezi, drejtor i SHP: Përshëndetje të gjithëve. Përshëndetje Esat. Momentalisht janë duke u bërë punimet për zëvendësimin e gypit kryesor i cili është nga asbesti. Në rrugën “Leonard Palucaj” ka përfunduar ndërrimi dhe tani është duke vazhduar në pjesën tjetër afër “Semirra” duke u bërë kyçja me

galerinë nëntokësore. Për momentin janë duke u bërë këto punime. Ka pasur ndërprerje të ujit për shkak të punimeve por që gjithmonë janë lajmëruar qytetarët përmes Radio "Alba".

z. Esat Raci: Kërkoj edhe një fjalë, kryesues. E di natyrën e kësaj pike të rendit të ditës por sa i përket ujit të pijes, a keni raport të fundit nga Instituti i shëndetit publik?

z. Ibër Elezi, drejtor i SHP: Me kërkesën e anëtarit të Kuvendit, Gjokë Lleshaj, unë i kam siguruar të gjitha analizat për vitin e kaluar dhe jua kam dërguar të gjithëve. Sot e morra me vete rastësisht raportin nga "Hidrodrini" Pejë. Mundem me e fotokopjuar dhe me jua dorëzuar të gjithëve. (Ndërhynë anëtari që bëri pyetjen, Esat Raci. Duke kërkuar që ky raport të dorëzohet në seancën e radhës).

z. Tunë Dedaj: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Fillimisht dua që të jua uroi festën e Fitër Bajramit të gjithë Shqiptarëve të besimit Mysliman. Kam një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike: Pse nuk fillon mbushja e gropave të krijuara në asfalt?

z. Ibër Elezi, drejtor i SHP: Faleminderit për pyetjen. Këtu me vete e kam vërejtjen e fundit që ja kam dhënë operatorit që ka kontratë për këtë punë. Më vjen keq prej popullatës por ju e dini se si janë procedurat e prokurimit. Të gjitha procedurat janë kryer por Operatori po i vonon fillimin e punimeve. Ne i kemi bërë vërejtjen e fundit e cila është vërejtje për ndërprerje të kontratës. Paraprakisht kemi pasur disa informacione se operatori nuk është shumë serioz, prandaj kemi kërkuar që të bëjë sigurimin e kontratës 100%, gjë që edhe e ka bërë. Tani në këtë situatë që jemi, ne do të ja ndalojmë sigurimin por gjithsesi edhe ne jemi humbës sepse punët nuk po kryhen. Më vjen keq vërtetë për situatën e krijuar edhe pse unë si menaxher dhe drejtor i Shërbimeve Publike e kam kryer në tërësi detyrën dhe obligimin që kam në lidhje me këtë kontratë.

z. Tunë Dedaj: Unë kërkoj që ati operatori ti ndërpritet kontrata menjëherë. Kompanitë që nuk janë serioze nuk duhet të punojnë në Komunën tonë.

z. Enver Gashi: Përshëndetje për gjithë të pranishmit. Problemi i qenve endacak, ky është një shqetësim i imi dhe i gjithë qytetarëve të Komunës sonë. Kërkoj një përgjigje nga drejtoria e Shërbimeve Publike se a ka zgjidhje ky shqetësim?

z. Ibër Elezi, drejtor i SHP: Faleminderit për pyetjen. Hiq më larg se dje e kam takuar njërin nga personat që kanë stacione veterinarë dhe ka qenë i kyçur vjetër në këtë problematikë. E kam fjalën për Noli Kabashin, i cili është zyrtar-përgjegjës në AVUK, por nuk kanë ndonjë plan për këtë vit. Buxheti është i tyre si dhe nga viti i kaluar gjitha kompetencat i ka AVUK. Ju kërkoj falje edhe juve edhe qytetarëve të Komunës por nuk është në dorën tonë si komunë.

z. Gjokë Lleshaj: Faleminderit kryesues. Përshëndetje të gjithëve. Përkundër pyetjes që pata për të bërë por në mungesë të kryetarit nuk po e bëjë. Po e shfrytëzoi rastin të bëjë një demant në lidhje me pasqyrimin që OJQ "Koha", i ka bërë fjalëve të mija, në revistën – botimet e saja, në lidhje me interpelancën e kërkuar nga unë në maj të këtij viti. Në interpelancën e Majit, kam kërkuar nga drejtori i Administratës për shpjegim për punësimet, të cilësuar nga unë si përshtatje të konkurseve për qëllime partiake. Kjo Organizatë, thotë-shkruan se drejtori i Administratës mu ka përgjigje pozitivisht me dokumente. Ndërsa fjalët e mija i tjetërsion krejtësisht. Kërkoj nga kjo organizatë që të kërkoj falje publike. Dua të lidhem pak edhe me pyetjen që e bëri kolegu, Tunë Dedaj dhe me përgjigjen që dha drejtori i SHP. Nuk ka arsyetim për mos kryerjen e punëve nga operatori ekonomik. Të besoi për situatën e zorshme që je, drejtor, nga përvoja e ime si drejtor ju them se zyra e prokurimit, nuk e di pse por nuk

bënë shkëputje të kontratave. Në mandatin sa kam qenë drejtor, me dhjetëra kërkesa për shkëputje të kontratave ju kam dërguar kësaj zyre por nuk ka ndodhë të bëhet ndonjë shkëputje. Nuk po dua që të të fajësoi ty, drejtor, por barra bie mbi ty gjithsesi.

z. Fadil Gashi, kryesues: Nuk jemi të barabartë me OJQ "Koha" sepse ata s'kanë të drejt që ta shfrytëzojnë foltoren. Është mirë me u rezervuar dhe kurdo që kjo organizatë të bëjë publike raportin tjetër dhe të organizon debat, të jua thoni atë që keni për të jua thënë.

Pika 4. e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për faljen e pjesshme të borxheve-qirasë komunale për rastet e banimit sociale me kushtëzim.

Kryesuesi, Gashi, për këtë pikë të rendit të ditës, fillimisht ja jep fjalën drejtorit të Drejtorisë FEZH.

z. Aziz Desku, drejtor i FEZH: Përshëndetje për të gjithë. Duke e pasur parasysh faktin se kemi të bëjmë me një kategori sociale, ku këta individ kanë shfrytëzuar të drejtën për të fituar banesë sociale. Duke u nisur edhe nga fakti se vlera e rritur e obligimeve për shfrytëzimin e atyre banesave është shumë e lartë duke u rritur edhe më nga muaji në muaj, ku në kushte normale është vështirë për tu inkasuar ky borgj, kemi marr këtë iniciativë për faljen e pjesshme të borgjëve por që falja të jetë e kushtëzuar me pagesën e borgjit të mbetur pas faljes. Kjo iniciativë fillimisht është shqyrtuar në bordin e drejtorëve dhe më pastaj si formë e propozim-vendimi është dërguar në KPF për të mbërritur sot këtu në Kuvend. Duke u nisur nga parimi se nga falja të përfitojnë të gjithë banorët e banesave sociale, kemi propozuar që falja të bëhet për të gjithë njësoi, për tre vite për të gjithë shfrytëzuesit. Kushti që të përfitojnë këtë falje është që shfrytëzuesit e banesave të paguajnë borgjin duke zbritur Shumen që falet në një afat kohor, të propozuar nga ne, prej një viti, duke filluar nga data 1 korrik 2019 deri me 30 qershor 2020, pra në 12 këste të barabarta sipas marrëveshjes për pagesë të borgjit, të nënshkruar nga Komuna, përkatësisht drejtoria FEZH me shfrytëzuesit e banesave. Në rast të dështimit të pagesave sipas marrëveshjes së nënshkruar, komuna do të inicioi procedurat për inkasim të detyrueshëm të borgjit si dhe do të bëhet ndërprerja e kontratës për shfrytëzimin e metutjeshëm të banesës. E gjithë kjo iniciativë ka për qëllim të krijoj lehtësira për shfrytëzuesit e banesave në njërin anë dhe rritjen e inkasimeve të borgjëve në anën tjetër. Gjatë shqyrtimit në KPF ka pasur propozime edhe për modalitete të tjera por ne vazhdojmë të konsiderojmë si më të mirë modelin e faljes së borgjëve për gjithë shfrytëzuesit pa përjashtim sepse mbi bazën e vlerësimit të statusit të tyre social e kanë fituar të drejtën e shfrytëzimit të banesës. Krejt në fund, ne kemi sjellë një propozim-vendim, e që është në dorën tuaj të merrni vendimin më të drejt dhe më merit. Ju faleminderit për vëmendje.

z. Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit drejtor. Ne e kemi shqyrtuar në KPF këtë propozim-vendim. Atëherë pati mbetur që të na sjellët edhe një listë e këtyre shfrytëzuesve sepse ka pasë fjalë se aty ka shfrytëzues të tretë të këtyre banesave. Mirë kish me qenë me e pasë atë regjistër, mbase në seancën e radhës.

z. Aziz Desku, kryesues: Më falë që po të ndërpres kryesues. Unë e kam dërguar në zyrën për punë të kuvendit dhe kam informatën se shefja e zyrës, znj. Grishe Gashi e ka përcjellë për tek anëtarët e kuvendit atë listë. Nuk e di nëse e keni pranuar.

z. Fadil Gashi, kryesues: Regjistrin-listën, as unë dhe as anëtarët e Kuvendit nuk e kemi pranuar.

z. Tunë Dedaj: Unë edhe në KPF, këtë mënyrë se si është parapa të falen borgjet, e kam kundërshtuar. Unë jam për, që atyre familjeve që e meritojnë të ju falet borgji, të ju falet komplet sepse ata nuk kanë

mundësi që të paguajnë. Në njëërën anë ju ndihmon shteti që të mbijetojnë e në anën tjetër jua kërkon paratë që nuk i kanë, as për bukë. Jam kundër faljes së borgjëve atyre familjeve që i kanë një e më shumë të punësuar. Nuk mundemi që ti trajtojmë të gjithë njësoi.

z. Enver Berisha: Edhe në KPF e kam theksuar se kjo çështje nuk është aq e thjeshtë sa duket. Ne, nuk e kemi marrë regjistrin që na është premtuar dhe në mungesë të këtij registri, ne si grup kuvendar nuk kemi pasur mundësi që ta shqyrtojmë siç do të duhej. Në emërtim është një gabim shumë i Madh. Nuk janë këta shfrytëzues të gjithë kategori sociale. Aty ka familje të dëshmorëve, ka invalid lufte dhe veteran lufte dhe pjesa tjetër është kategori sociale. Ndoshta është mirë mos me e bërë një përgjithësim të tillë sepse dikush mund të mos e pranojë atë klasifikim. Për veç faktit që është kjo përbërje shfrytëzuesish është edhe koha prej 10 vitesh që këta persona i shfrytëzojnë këto banesa. Ndoshta para 10 viteve ka qenë rast social por tani nuk është rast i tillë, prandaj është mirë që të bëhet një analizë dhe verifikim rast për rast. Jam i sigurt që ka ndryshime të mëdha për mos me thënë se ka raste kur shfrytëzuesi i banesës sociale sot ka arritur në nivelin shumë më të lartë ekonomik sesa shumë familje që nuk janë raste sociale. Duhet të bëhet dallimi, e kam thënë edhe në KPF dhe jemi dakorduar me këtë edhe me Tunën, nuk është i barabartë ai që merr një ndihmë sociale prej 70 deri në 100 euro me atë familje që ka një e më shumë të punësuar. Kërkesa e grupit tonë kuvendarë është që fillimisht të furnizohemi me listën e shfrytëzuesve të atyre banesave sociale me tërë analizën se si është gjendja duke përfshi edhe shumën e borgjëve. Pastaj, për marrjen e vendimit për faljen e borgjëve, ne jemi PËR vetëm nëse bëhet dallimi, d.m.th., të ju falet në tërësi borgji familjeve që vërtetë e meritojnë, përfshi këtu edhe kategoritë e dala nga lufta që nuk kanë paga mujore përveç beneficioneve që i marrin. Ta bëjmë një analizë të mirë nëse duam që të nxjerrim një vendim të mirë. Duke u bazuar në të gjitha këto që i thash, kërkoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet derisa të jemi furnizuar me listën e nevojshme si dhe analizën e duhur.

z. Valmir Bacaj: Edhe ne si grup Kuvendar mendojmë që më e arsyeshme është që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës për një seancë tjetër, në mënyrë që mos të biem në lajthitje si Kuvend dhe ti falim borgjet personave që ndoshta janë edhe duke i keqpërdorë ato banesa.

Znj. Violeta Zefi: Nëse nuk është urgjente miratimi i këtij propozim-vendimi, edhe grupi ynë kuvendarë i mbështetë grupet e tjera që të shtyhet kjo pikë e Rendit të Ditës.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi e vënë në miratim shtyrjen e kësaj pike të Rendit të Ditës për seancën e radhës por jo më shumë se sa në seancën e radhës. Me 25 vota PËR, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Miratohet shtyrja e kësaj pike të rendit të ditës për seancën e radhës.

Pika 5. E Rendit të Ditës: Pezullimi i dy vendimeve të miratuara nga Kuvendi i Komunës Klinë:

a. Vendimit 01nr.06-9089/2019 të datës 05.03.2019 lidhur me ngastrën nr.66/4 në ZK-Dresnik-Komuna Klinë (ref.Drejt.UMM),

b. Vendimit 01nr.06-9086/2019 të datës 05.03.2019 lidhur me ngastrën nr.515/4 dhe 515/6 ZK-Klinë (ref.Drejt.UMM),

z. Fadil Gashi, kryesues: I kam edhe vendimet edhe konfirmimet nga Ministria përkatëse që ka kërkuar që ti pezullojmë këto vendime deri në miratimin e hartave zonale. Këto harta zonale janë në përfundim e sipër dhe unë mendoj që shumë shpejt ka me na ardhur në kuvend materiali i nevojshëm dhe me e përfunduar procedurën për miratim të këtyre hartave zonale. Ne sot kërkojmë që ti pezullojmë dy këto

vendime që I kemi miratuar në seancat tona, deri në miratimin e hartave zonale. Pra nuk është pezullim final por vetëm deri në miratim të hartave zonale. Pas miratimit të hartave zonale, janë këto të fundit që I trajtojnë këto çështje. Jemi të detyruar që të ju bindemi shkresave dhe kërkesave të Ministrisë, pasi që ata i kontestojnë vendimet tona duke u thirrur në atë se I kemi planet e miratuara: planin zhvillimor urban, planin rregullativ detal dhe këto plane nuk mund të ndryshohen pa kaluar 8 vite nga miratimi I tyre. Mundësia e vetme është përmes hartave zonale e që e konsideroi një të mirë të veçantë pasi që këto harta, Komuna e Klinës¹ ka në përfundim e sipër. Kërkoj mirëkuptimin e juaj që ti pezullojmë këto vendime ashtu siç ka kërkuar Ministria.

z. Enver Berisha: Realisht kjo që po ndodhë me ne është goxha shqetësuese. Nuk është hera e parë, përkundrazi goxha shumë herë po ndodhë që vendimet që ne I marrim këtu të mos na pranohen. Kjo më bënë të pyes se kush jemi ne këtu?! A kemi ne organe dhe zyrtarë që duhet me kohë të I trajtojnë këto tema, këto vendime, duke e përfshi zyrën ligjore gjithsesi. A e kemi harmonizuar deri në fund situatën për marrjen e vendimeve dhe të drejtën për marrjen e vendimeve të tilla? Nëse nuk janë kryer këto veprime paraprakisht, dhe nëse ne kemi bërë kapërcime në hapa deri në nxjerrjen e vendimit, realisht është jo serioze nga ana e jonë. Por, nëse ne I kemi në përputhshmëri të gjitha hapat deri në vendimin e marrur dhe qoftë për teke apo mos kujdes të organeve në nivelin qendror, këto vendime kthehen mbrapa, prap është jo serioze. Në këtë rast do të duhej dikush nga Komuna, ose kryesuesi ose kryetari që ti takoi këto organe në nivelin qendror dhe të sqarohet se çfarë po ndodhë me vendimet tona. Dikush duhet të mbajë përgjegjësi në gjithë këtë. Ndoshta zyra ligjore mund të na sqaroj më mirë, por unë dua të sigurohem se arsyeja e kthimit të vendimeve tona mos të jenë gabimet në mos formulime të duhura etj. nga zyra jonë për punë të kuvendit. Është mirë që të shikohen më mirë këto punë tash e tutje sepse është vërtetë fyerje për ne si Kuvend me gjithë këto vendime që po na kthehen kohëve të fundit.

z. Fadil Gashi, kryesues: Ky është një shqetësim I joni I përbashkët. Tek kthimi I vendimeve, jo gjithherë kanë të drejt. Mund të them se goxha shumë herë, ata, nuk kanë të drejt. Jemi nivel lokal prandaj nuk mund ti kontestojmë vendimet e tyre ndërsa ata po, vendimet e tona. Po jua jap edhe një informacion shtesë, ata kanë kërkuar edhe rregulloren për taksa dhe tarifa me e kthye në rishqyrtim për të tretën herë. Nuk e kemi bërë, jua kemi kthyer një sqarim, problem është tek ata në këtë rast sepse nuk po kanë kohë apo s' di pse nuk I lexojnë shkresat qysh duhet. Absurdi I kësaj është se në lidhje me këtë rregullore, fillimisht na e kanë kthyer konfirmimin se rregullorja në fjalë mund të krijoj efekte juridike ndërsa pas 30 ditë pune, I njëjti institucion, e kanë dërguar shkresën tjetër se nuk prodhon efekte juridike. Edhe për rregulloren por edhe për këto dy vendime, ne jua kemi dërguar një shkresë dhe jemi duke pritur sqarime nga ana e tyre. Ju e dini, besoi që edhe nga ministria po na përcjellin përmes teleprezences, se është një udhëzim dhe akte të tjera nënligjore që e kanë miratuar vetë e ku thuhet se nëse Kuvendi I Komunës ose Komuna, pas shqyrtimit të aktit të ligjshmërisë, nëse brenda afatit prej 15 ditëve, nuk marrin përgjigje për këtë ligjshmëri të aktit, atëherë akti shpallet në gazetën zyrtare dhe është I implementueshëm. Për njërën shkresë ne kemi marr përgjigje pas 50 ditë pune dhe për njërën shkresë tjetër pas 30 ditë pune. D.m.th. janë vonuar shumë në kthimin e përgjigjes, gjë që na ka nxjerr telashe duke u detyruar që pas shpalljes në gazetë zyrtare të tërhiqen vendimet. Por, kur jemi tek këto dy vendimet që po I debatojmë, Ministria ka të drejt. Në këtë rast po kërkoj mirëkuptim nga Kuvendi dhe ti pezullojmë këto dy vendime. Në të kundërtën, ata mund të na dërgojnë lëndën në gjykatë.

z. Tunë Dedaj: Kjo çështje është shumë shqetësuese. Ne qytetarët e Klinës e dimë se tek vendi ku është bërë ndryshimi, ka funksionuar një depo për 20 vite radhazi, nuk ka qenë asnjëherë shtëpi banuese. Unë e konsideroi shkelje të të drejtave të qytetarit, pasi që po pengohet në zhvillimin e biznesit e që unë

mendoj që dikush në qeveri e ka marr ndonjë lekë për pengesën e kësaj veprimtarie afariste dhe unë e ftoi prokurorinë që të merret me këtë rast. Gjithashtu ju bëjë ftesë anëtarëve të kuvendit që mos ta pezullojmë këtë vendim. Jemi të gatshëm që të merremi edhe me gjykata. Ne duhet që të përkrahim çdo njerin që dëshiron të vijë në Klinikë për të investuar dhe mos të pengojmë sepse kështu nuk e ndihmojmë zhvillimin ekonomik të Komunës dhe punësimet e reja.

z. Fadil Gashi, kryesues: Nuk ka të bëjë në këtë rast as me individin as me pronën private. Kat ë bëjë me një vendim që e kemi nxjerrë ne si Kuvend dhe nuk ka rendësi se a e pezullojmë ne sot apo jo. Në të dy rastet, drejtoria nuk mund të ju lëshoi leje për punë-vazhdimin e punës sepse janë të obliguar që t'ju binden planit rregullativ detal që është në fuqi. Nuk është fjala vetëm për ngastrën e qytetarit, z. Palushaj, por për tre vendime të së njëjtës natyrë-ndërrimin e destinacionit të pronës. Nëse nuk i pezullojmë vendim, ta kemi të qartë se nuk i ndihmojmë palës gjithsesi, përkundrazi mund të vonohen edhe më shumë procedurat pasi që drejtoria e linjës nuk guxon të merr asnjë veprim.

z. Valmir Bacaj: Në fakt, unë i konsideroi të çuditshme vonesat në kthimin e përgjigjes së ministrisë (MAPL) për ligjshmërinë e një vendimi të nxjerrë nga Kuvendi i Komunës. E them këtë duke u bazuar në ligjin për qeverisje lokale nr. 03N 040 neni 81. Paragrafi 81.4 i këtij neni, është e obliguar MAPL që për ligjshmërinë e vendimit që e dërgon Komuna, të kthejë përgjigje brenda afatit prej 15 ditëve. Më pastaj, Komuna e bënë publike vendimin dhe pas 7 ditëve ligjërisht është i vlefshëm ai vendim. Duke kthyer përgjigje pas 30 e 50 ditëve dhe duke u detyruar Komuna që të tërheq vendimin pasi e ka bërë publike, ne i dëmtojmë bizneset dhe qytetarët si dhe krijojmë performancë jo të mirë pasi që qytetarët e kanë parë e lexuar vendimin e publikuar dhe kanë filluar punën sipas atij vendimi. Unë do të doja një sqarim nga administrata publike dhe të shikohet se a ka organ që e mbikëqyrë punën e kësaj administrate në MAPL.

z. Fadil Gashi, kryesues: Po jua bëjë me dije përsëri. Ne , jua kemi dërguar një shkresë me kërkesë për sqarim për këtë kërkesë për pezullim të vendimeve. Jemi duke e pritur përgjigjen nga Ministria. E them edhe një herë që nuk është fjala vetëm për një vendim që kërkohet pezullim por edhe për të tjera siç është rregullorja për taksa dhe tarifa dhe të tjera.

z. Gjokë Lleshaj: U thanë gati të gjitha nga parafolësit. Të pezullohet një vendim yni që e kemi marr, mendoj që është e padrejtë dhe e pandershme dhe fyerje për Komunën. Unë pajtohem me parafolësit dhe nuk do ta votoj pezullimin e këtyre vendimeve. Do të ishte një dëm i madh që do ti bënë qytetarit dhe operatorit ekonomik që do të investonte në Komunë.

z. Enver Berisha: Dua ta ngrit edhe një shqetësim tjetër. Ju, kryesues, e thatë që jemi nisur nga vullneti i mirë prandaj kemi marr vendimin për ndryshimin e destinacionit të tokës, por nëse ne kemi bërë shkelje, vullneti i mirë nuk mjafton në këtë rast. Çfarë të bëjmë tutje? Kam një kërkesë që ju bashkë me zyrën tonë ligjore të kërkojnë një takim me përfaqësues të ministrisë dhe të sqarohet çështja e kthimit në rishqyrtim të vendimeve të Kuvendit, kthimit të përgjigjes pas afatit kohor. Para qytetarëve të Komunës, ne si përfaqësues të tyre në Kuvend po dalim keq, sikur s'po dimë ose s'po mundemi me vepruar. Mendoj që situatë është e ndijshme dhe shumë serioze.

Znj. Violeta Zefi: Po më duket paksa konfuze për të gjithë kjo situatë. Nëse e ndihmojmë në kthjelltësi këtë situatë, propozoi që ta shtyjme këtë pikë të rendit të Ditës.

z. Fadil Gashi, kryesues: Po jua lexoi formalisht shkresën e Ministrisë, një pasues të fundit: Kërkojmë nga Komuna që zyrtarisht të njoftohemi lidhur me ndërmarrjen e veprimeve konkrete për rishqyrtimin e këtij akti. Enveri e tha mirë, nuk është çështje e lehtë siç po duket. Nuk është puna e vullnetit të kryesuesit apo të anëtarëve të Kuvendit. Kanë kërkuar që ta rishqyrtojmë aktin dhe hapi I dytë I tyre është gjykata. Mos të krijohet përshtypja që unë prettoi me shkuar në gjykatë, sepse ata nuk ju thërrasin juve në gjykatë por mua. Unë them që mos të futemi në një situatë pa zgjidhje derisa e kemi një zgjidhje. Edhe nëse nuk bëjmë pezullimin e kërkuar, nuk mund ti ndihmojmë palës, drejtoria përkatëse nuk mundet me leshu asnjë lloj dokumenti-leje. U tha edhe në kuvend se paska filluar me u implementu në teren, d.m.th., kanë filluar punimet- përgjegjësinë le ta marrin ata që ju kanë thënë që të punojnë. Unë jua bëjë me dije që vendimet që I ka marr kuvendi, ne, I kemi në sirtarë dhe nuk jua kemi dhënë palëve pasi që ne kemi pritur konfirmimin e ligjshmërisë së vendimeve. Ne e kemi pritur ligjshmërinë e vendimeve dhe po e ritheksoi, nuk jua kemi dhënë palëve vendimet. Ai që nuk ka pritë dhe I ka kapërcyer nga dy shkallë, nuk është problem I imi. Për fund, unë jam me ju, qysh të doni e vendosim por palëve nuk mund të ju ndihmojmë as me mos pezullim të vendimeve.

z. Enver Berisha: Është mirë të thuhet një gjë, hapur. E drejta e zyrtarit në njëfarë forme është mohuar. Nuk I frikohemi gjykatës pasi që gjykata është edhe për ne por edhe për Ministrinë. Mendoj që Ministria e ka të njohur se pas 15 ditëve të mos kthimit të përgjigjes për ligjshmëri të vendimit, Komunitat kanë të drejt ta bëjnë publike dhe implementojnë.

z. Avni Gashi: Dua të kthehem pak tek hartat zonale që do të aprovohen së shpejti, pyetja ime është: A zgjidhet ky problem me aprovimin e hartave zonale? Është pak problematike kjo punë, nuk mund të shtyhem me Ministri sepse asnjëri nuk fiton. Nëse zgjidhet problem me aprovimin e hartave zonale atëherë është mirë që të intensifikojmë punën për përgatitjen e atyre hartave.

z. Xhevgjet Berisha: Përshëndetje për të gjithë. Meqenëse drejtori I Urbanizmit nuk është këtu, do të doja ta pyesja drejtorin se a e ka prit afatit prej 15 ditëve. Jemi në një situatë që s'po dimë se sit ë veprojmë. E kemi zyrën ligjore të pranishëm është mirë me na ndihmuar në këtë çështje dhe mundësisht mos të futemi në situatë të rënda.

z. Isa Ibishi: Mendoj që gabimi është bërë më herët, drejtoria ka mundur me ja dhënë lejen pasi që aty në atë parcelë me leje kanë punuar tre biznese. Kemi ardhë në këtë situatë për të cilën po debatojmë, tani, cila është rruga më e shkurtër për me ardhë tek realizimi I sajë që mos të pengohet as investitori dhe as pronari.

z. Fadil Gashi, kryesues: Plani rregullativ detal është miratuar në vitin 2015, në atë plan ka planifikim të rrugëve që trupon parcelat, shtëpiat private- I urbanizon. Pronari I shtëpisë që përfshihet në Plan, pasi ta rrëzon shtëpinë nuk mund ta ndërtoj përsëri në atë parcelë. Prandaj duhet të priten hartat zonale sepse vetëm me ato harta mund të bëhet zgjidhja. Besoi që edhe zyra ligjore ka për të thënë mendimin e sajë për këtë çështje. Urdhëro, Ali Shala.

z. Ali Shala, zyrtar ligjor I Komunës: Përshëndetje për të gjithë. E kuptoi rëndësinë e kësaj çështje dhe jua them se në tërësi pajtohem me shpjegimet që I dha kryesuesi I Kuvendit. E kam thënë edhe më parë , që jo për ta hequr përgjegjësinë nga pushteti lokal, por defektet kryesore I kemi tek niveli qendror. Përsëri kërkoi që mos të keqkuptohet sepse skam qëllim ta bart përgjegjësinë tonë atje lartë. Ne kemi shkresa nga zyra për punë e Kuvendit, me aktet tona të mira apo të këqija, që janë dërguar me afate ligjore në Ministrinë kompetente. Atje kemi një komision të shpërndarë prej Ministrie në Ministri tjetër,

varësisht nga çështja që shqyrtohet vlerësimi i ligjshmërisë. Aq sa kam unë njohuri, ata asnjë herë nuk kanë kthyer përgjigje në afat të duhur. Prandaj shpesh e kam thënë dhe po e përsëris, nuk është mirë që niveli qendror me I vënë para akteve të kryera Komunitat, sepse këto janë raste me pasoja të mëdha juridike. Dua të them për fund se zyra ligjore e Komunitës nuk është ajo që “ja qet kapakun” kësaj pune. Mund të japim sqarime sa të doni por ai që vendosë në fund është niveli qendror, natyrisht në koordinim me ne. Kemi edhe ne defekte, duhet ta pranojmë. Çdo vendim që është i natyrës juridike, duhet ti nënshtrohet fazës së procesit të shqyrtimit paraprak që është e paraparë me ligjin e Vetëqeverisjes Lokale. Këtë segment, ne, nuk e kemi shfrytëzuar sa duhet. Në lidhje me vendimet në fjalë, ndoshta është dashur paraprakisht, para se të vije në asamble propozim –vendimi, të shkohet në Ministrinë përkatëse dhe të merret opinionin i tyre se si mendojnë ata, do të mund të kalonte apo jo sa i përket ligjshmërisë, ai propozim vendim. MAPL, tani pret nga ne se çfarë kemi ndërmarrë për sqarimin e këtij rasti, dhe ne jemi për këtë duke debatuar sot, por fatbardhësisht ka zgjidhje që unë e dëgjova pak më herët. Ishte një mendim i mençur i thënë nga anëtar i Kuvendit, z. Avni Gashi. Hartat Zonale, rregullojnë çdo imtësi, çdo detaj në aspektin urbanistik. Ky është akti që na nxjerr nga kjo situatë. Kompania që po i përgatitë hartat e tilla duhet të ketë bashkëpunim shumë të afërt me dikasteret tona profesionale dhe rregullimin e qytetit ta bëjmë siç duam ne e jo siç dëshiron kompania. Edhe një herë për rastin në fjalë, janë procedurat, rregulloret në fuqi. Ne e kemi dërguar aktin për shqyrtim ligjshmëria, kemi pritur afatin ligjor dhe kemi vepruar sipas rregullores. Ministria nuk ka vendosë në afatin e caktuar sipas udhëzimeve ligjore dhe duke i respektuar ato udhëzime, ne, Aktin e kemi futë në fuqi me gjithë pasojat e mundshme, të mira apo të këqija. S’po di se çfarë të shtoi më shumë, jemi para një akti të kryer.

z. Enver Berisha: z. Ali Shala, kam dy çështje për të cilat dëshiroi të kem mendimin tuaj. Konkretisht, a kemi pasur ne të drejtë në nxjerrjen e këtij vendimi? Dhe e dyta: A ka të drejtë Ministria që ta shfuqizoj Vendimin tonë, duke pas parasysh vendimin e pas afatit ligjor të Ministrisë?

z. Ali Shala, zyrtar ligjor i Komunitës: Ne kemi nxjerr një vendim, por kjo s’do të thotë që ja kemi qëlluar. Ka pas raste edhe në të kaluarën që nuk ja kemi qëlluar dhe janë bërë korrigjimet e duhura më pastaj. Edhe në këtë rast, kemi rastin që përmes hartave zonale të bëjmë rregullimin. E tha edhe kryesuesi, është ligji për planifikimin hapësinor, i cili tregon se deri në cilën fazë lejon që të bëhen plotësim-ndryshimi i planeve zhvillimore Komunitale dhe i planeve rregulluese të hollësishme. Është afati 8-të vjeçar. Çdo vendim që bije ndesh me këtë, nuk është i ligjshëm. Tani jemi para një akti të kryer që duhet të bëjmë zgjidhje dhe zgjidhja është tek përpunimi i hartave zonale jo vetëm për atë pjesë por për të gjitha.

z. Esat Raci: z. Shala, meqenëse jemi në këtë situatë, Vendimi i jonë, sot, për pezullim, a mund të jetë i afatizuar deri në përfundimin e hartave zonale?

z. Ali Shala, zyrtar ligjor i Komunitës: Po, mund të jetë me afat të tillë të caktuar. Me hartat zonale jemi diku Komuna e tretë e radhitur sa i përket përgatitjeve të tyre. Komunitat e tjera as që kanë filluar. Vetëm edhe një segment ta potencoi, në lidhje me konfirmimin e ligjshmërisë së vendimeve të Kuvendit, që unë mendoj që shumë herë as që i lexojnë se çfarë kemi shkruar. P.sh. tek rregullorja e taksave, paradoksale duket vërejtja e tyre. Kanë ndërhyrë në kompetencat ekskluzive të Komunitës, paramendoni, arrijnë deri aty sa të caktojnë se çfarë shume duhet të këtë taksa e caktuar. Nëse ne kemi harruar që të paraqesim ndonjë lloji takse, është çështje tjetër por jo caktimin e vlerës së taksës, nuk është çështje e Ministrisë kjo. Që mos të dalim nga rrjedhat e koordinimit të më hershëm ne megjithëkëtë i kemi përfshi

rekomandimet e tyre në këtë rregullore, por kurrësi nuk është kompetencë e tyre të na diktojnë se çfarë shume duhet të ketë taksë e caktuar. Përfundimisht, është mirë të nxitojmë me hartat zonale edhe pse jemi të parët që po prijmë në nivel vendi.

z. Petrit Palushaj: Meqenëse jeni profesionit, z. Shala, që mos të zgjatet ky debat dua të të pyes se a bëjmë mirë që ti pezullojmë këto vendime që na kanë rekomanduar apo jo?

z. Ali Shala, zyrtar ligjor: Nuk kemi alternativë tjetër përveç se me t'pezualluar. Nëse ne nuk ndërmarrim asgjë, atëherë ministria e ka të vetmen rrugë, ajo është gjykata dhe neve na del telashe më e madhe.

z. Fadil Gashi, kryesues: Ne nuk jemi duke e anuluar vendimin tonë. Ne jemi duke e pezulluar deri në hartimin e hartave zonale. E njoftojmë Ministrinë që t'kemi rishqyrtuar vendimet dhe t'kemi pezulluar, kështu në këtë mënyrë e ndihmojmë veten tonë si dhe palën më shumë se sa nëse nuk t'pezuallojmë.

z. Gjokë Lleshaj: Faleminderit kryesues. U debatua shumë kjo çështje. Meqenëse Ministrisë përkatëse duhet të ja dërgojmë një shkresë për këtë çështje, ne mund të jua dërgojmë atë shkresë dhe t'jua bëjmë me dije që Anëtarët e Kuvendit e kanë shqyrtuar por kanë vendosur mos ta pezullojnë. Unë nuk do ta votoj këtë pezullim.

z. Tunë Dedaj: Unë personalisht këtë vendim nuk e votoj për ta pezulluar pasi që po e konsideroi që po t'bëhet e padrejtë qytetarit.

z. Tush Dedaj: Mendoj që nëse e pezullojmë tani, marrim fajësinë derisa faji është t' tyre që janë vonuar në kthimin e përgjigjes.

z. Petrit Palushaj: Unë propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e ardhshme. Mendoj që është më mirë të shtyhet se sat t'votohet gabim.

z. Fadil Gashi, kryesues: Petrit, ne kemi afatin ligjor prej 30 ditëve që t'jua kthejmë përgjigjen. Nëse e shtyjmë do të kalojmë afatet. Janë dy vendime dhe jemi duke pritë përgjigjen e ligjshmërisë për vendimin e tretë, "Nojtra", nuk jemi simpatizant të asnjë pale por referojuni ligjeve. Ne mund të demonstrojmë mos dëgjueshmëri institucionale, në çdo rregullore Komunale që nxjerrim ose akt a vendim ne si Kuvend, me siguri e keni lexuar se në fund shkruan: Çdo zbrazëti që mërehet në këtë akt, vlejnjë ligjet në fuqi dhe aktet e tjera nënligjore të nivelit qendror. Unë e kam obligim me jua prezantuar kështu siç t'kam pranuar rekomandimet, mos mendoni që jam pro ose kundër, në një mendim me ju jam dhe do të vendosi ashtu siç do të vendosni ju në fund.

z. Enver Berisha: Duke e parë edhe vullnetin si dhe shqetësimin e kolegëve asamblistë dua që ti them dy gjera. E para ky shqetësim t'yni sot është lloj mllëfin për përgjigjen që e kemi marrur me shumë vonesë nga Ministria. Kjo na jep një të drejtë për një përballje të mundshme me Ministrinë në çfarëdo rrethane, pa e përjashtuar ndonjë defekt të vogël para nxjerrjes së vendimit. Meqenëse ju keni bërë një shkresë-kërkesë për sqarim dhe përgjigja s'ka ardhur akoma, mendoj që ndoshta do të duhej që kryetari ose ju kryesues të zhvillonin një takim të drejtpërdrejt me Ministrinë dhe më pastaj të thirret një seancë e jashtëzakonshme dhe të vendoset për këtë çështje. Prandaj meqenëse shumë u deklaruan në favor të shtyrjes së kësaj pike të rendit të ditës, edhe ne po dakordohemi që ta shtyjmë.

z. Sefa Morina: Përsëritet për të gjithë. Ju edhe më herët e thatë shumë mirë që këto vendime duhet të pezullohen që të hapet rrugë për zhvillime të tjera. Në këtë mënyrë t'jam shansë edhe qytetarit tonë që ta realizoi planin e investimit.

z. Fadil Gashi, kryesues: Vetëm ta sqarojmë edhe një herë. Ne nuk jemi duke e diskutuar pronarin, kompaninë dhe investimin por ngastrën.

z. Gjokë Lleshaj: Unë besoi se çfarëdo përgjigje që marrin nga ne Ministria është përgjigje. Këtu ka ndërtime me leje e pa leje, në të kaluarën dhe tani. Tani po diskutojmë për një investim në një pronë private, një ndërtim që për mendimin tim nuk është dashtë me marr leje hiq por ok e ka nisë këtë procedurë. Tani, a e votojmë PËR ose KUNDËR, cila do nga këto do të jetë përgjigje për Ministrinë. Dhe se a ju pëlqen atyre ose jo, është punë e tyre. S'kemi nevojë që ta shtyjme këtë pikë të rendit të ditës sepse nëse e shtyjme d.m.th. nuk është shqyrtuar fare.

z. Xhevgjet Berisha: Sa e shoh unë s'kemi nga me shkuar tjetër përveç se me i pezulluar këto vendime. Komisioni dhe kompania për hartat zonale të ngutet pak me punën dhe pastaj me hartat zonale, edhe pronari edhe kompania të vazhdoi punimet pa pengesa.

z. Fadil Gashi, kryesues: Për fund, po e ritheksoi mendimin tim se si mund të vijnë situatat. Nëse nuk e pezullojmë nuk mund ti ndihmojmë asgjë palës dhe përveç kësaj Ministria mund ta dërgoi lëndën në gjykatë. Nuk është se kemi frikë nga Gjykata por në atë rast gjithçka do të pezullohet deri në një vendim Gjykate dhe as me harta zonale nuk mund të bëhet gjë pastaj, ju e dini se sa mund të zgjasë procesi në Gjykata, atëherë palës në fjalë do ti shkaktonim vërtetë një dëm të madh. Nuk dua që t'jua imponoi as PËR as KUNDËR, por jemi këtu që të vlerësojmë me mendje dhe jo me zemër.

z. Baki Gashi: Përshëndetje të gjithëve. Realisht unë këtë që e the në fund, e kisha për qëllim që ta thoja. Unë nuk e njoh as pronarin dhe as investitorin për të cilin u fol, por duhet ta dimë që fjala e fundit sa i përket planifikimit hapësinor është e Ministrisë përkatëse. Mos pezullimi i këtij vendimi do ta vendosë edhe drejtorinë e Urbanizmit në një presion të Madh nga pronarët pasi që ata do të kërkojnë leje nga kjo drejtori dhe e cila do ta ketë të pamundur në këtë rast që të jep leje. Rruga më e mirë është që të pezullohet dhe më pastaj të trajtohet me kujdes ajo ngastër. Këtë trajtim të kujdesshëm, sipas kërkesës së pronarit, duhet rekomanduar edhe hartuesve të Hartave Zonale.

z. Tunë Dedaj: Kërkoj falje se e morra shumë herë fjalën por kolegët besoi e kuptojnë se gabimi është i Ministrisë që nuk e ka kthyer në afat të duhur përgjigjen për ligjshmërinë e vendimit tonë, prandaj vendimi i ynë është i plotfuqishëm. Unë kërkoj që ta vendosësh në votim, ta votojmë mos pezullimin dhe më pastaj ati pronari ti jepet leje ndërtimi gjithsesi.

z. Enver Berisha: Nëse ju është drejtuar Ministrisë me një shkresë, pse nuk insistohet që të merret një përgjigje e shpejt. Dhe nëse duhet seancë e jashtëzakonshme për vendim të ri, të thirret. Un të bëhet javën e ardhshme ose pas 10 ditëve, kurdo që ta vlerësoni ju.

z. Fadil Gashi, kryesues: Ne mund të dërgojmë shkresë dhe t'jua bëjmë me dije në ministri se Kuvendi ka filluar shqyrtimin sipas rekomandimeve. Pavarësisht se ne ju kemi dërguar shkresë për sqarim se ata janë vonuar 50 ditë në kthimin e përgjigjes për këtë vendim, vendimi i Ministrisë edhe pse me vonesë është vlefshëm sepse ata thonë se ne kemi marr një vendim të kundërligjshëm. Shkelja e udhëzimeve dhe rregulloreve nga ana e Ministrisë është evidente por sipas Ministrisë Vendimi i ynë është i kundërligjshëm. Pra duhet të vlejë kjo që Ministria e thotë. Nëse ju pajtoheni, ne po ju dërgojmë një përgjigje se ne e kemi filluar shqyrtimin e vendimeve sipas rekomandimeve, njëkohësisht jemi duke e pritur përgjigjen për shkresën e dërguar në Ministri, dhe në bazë të përgjigjes së tyre, ne, në seancën e radhës po vendosim.

z. Avni Gashi: Unë jam dakord por ndërkohë të rritet intensiteti rreth përgatitjeve të hartave zonale.

z. Fadil Gashi, kryesues: Tek Hartat Zonale, fillimisht kemi pasë një pengesë pasi që një kompani që i është nënshtruar procedurave të tenderimit është ankuar dhe ka ngecë puna. Ne kemi thirr një kompani tjetër profesionale gjithashtu dhe e kemi lutë që të na i punoi hartat zonale pa asnjë Kompensim. Fatmirësisht, kompania ka pranuar dhe janë duke punuar në përpilimin e këtyre hartave. Unë besoi që nëse shpejtojmë pak, mund të fillojmë shumë shpejt me procedurat tona. Inicimin në Kuvend, shqyrtimin publik dhe në seancën e radhës pasë këtij shqyrtimi publik e miratojmë. Po e vendosë në votim propozimin tim siç e thash më herët që përgjigja e jonë për Ministrinë në lidhje me rekomandimin e tyre për shqyrtim dhe pezullim të vendimeve të cekura më herët të jetë: Kemi filluar shqyrtimin e vendimeve sipas rekomandimeve, njëkohësisht jemi duke e pritur përgjigjen për shkresën e dërguar në Ministri. Kush është PËR?

Kryesuesi z. Fadil Gashi, e venë në votim propozimin e tij për përgjigje Ministrisë dhe me 25 vota PËR asnjë kundër dhe asnjë abstenim, MIRATOHET.

Pika e 6. E Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Klinës 2019-2023.

Kryesuesi i Kuvendit, për këtë pikë të rendit të ditës, fjalën ja jep kryesuesit të grupit punues, z. Binak Sylja.

z. Binak Sylja, drejtor i Administratës: Faleminderit kryesues. Sa i përket Planit të Veprimit për Transparencë, mendoi që e keni shqyrtuar edhe në të kaluarën pasi që ky plan është kthyer në rishqyrtim për arsye të harmonizimit me Komunitatet e tjera. Duke e falënderuar zyrën e Informimit, zyrën ligjore dhe zyrën për punë të Kuvendit i kemi bërë të gjitha ndërhyrjet e nevojshme dhe mendoi që kjo që e keni ju tani para vete është e kompletuar por gjithsesi mendimet, vërejtjet dhe sugjerimet e juaja do ta fuqizonin edhe më shumë. Propozoi që të hapet debat ose të miratohet si i tillë ky Plan veprimi për transparencë në Komunë. Ju faleminderit.

z. Enver Berisha: Ashtu siç e tha edhe drejtori, ky është një plan i debatuar më parë, ka qenë në diskutim publik gjithashtu, e kemi shqyrtuar e rishqyrtuar edhe ne si KPF. Ne jemi në pajtueshmëri të plotë që ky plan i veprimit të aprovohet pa debat.

Kryesuesi i Kuvendit e venë në miratim planin e veprimit për transparencë dhe unanimisht me 25 vota PËR asnjë kundër, dhe asnjë abstenim, MIRATOHET.

Pika e 7. E Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për Formimin e Komisionit vlerësues - ad hoc, për ndarjen e titullit "Nderi i Qytetit" në Komunën e Klinës.

Kryesuesi i Kuvendit shpjegon procedurat dhe rregulloren për ndarjen e këtij çmimi dhe kërkon që të formohet një komision prej 7 anëtarëve: 2 nga ekzekutivi, 4 nga Kuvendi (2 nga Opozita dhe 2 nga Pozita) dhe 1 nga shoqëria civile. Në vazhdim, hapet debat.

z. Enver Berisha: Këtë qasje e kam më shumë me juve kryesues, duke përfshi edhe drejtorin e financave dhe kryetarin e Komunës. Ne kemi formuar shumë komisione deri me tani dhe kemi parë që shumë komisione nuk e kanë kryer punën e vet. Një nga këta komisione është Komisioni për bursa që disa herë shkarkohet dhe formohet i riu shkaku që nuk kryhet puna siç do të duhej dhe për pasojë të kësaj, studentët kanë ngelë pa i marr mjetet e tyre. Nuk e di përgjegjësi e kujt është që të thirrën anëtarët e

komisioneve që të ulen dhe të kryejnë obligimet që i marrin përsipër. Po i ofrohem dy vite e gjysmë mandat dhe akoma asnjë kërkesë nga asnjë komision nuk na ka ardhur në kuvend për shqyrtim. Kjo është vërtetë shqetësuese. Por, përkundër kësaj, jam mese i bindur se problemi i kësaj është mos pagesa e komisioneve. Unë po flas në emër të grupit tonë, nëse deri në fund të vitit nuk kryhen këto pagesa për komisionet, ne nuk do të marrim pjesë në asnjë komision pas kësaj date. Këtë punë duhet marr seriozisht, ka qenë premtim edhe i juaji kryesues por edhe i kryetarit. Sidomos duhet bërë zgjidhja për anëtarët e komisioneve që nuk janë në marrëdhënie pune. Duhet parë mundësitë që të gjejmë formën se si të paguhen komisionet.

Për komisionin sipas rendit të ditës, u propozua, z. Zeqir Morina, z. Gjokë Lleshaj, z. Tunë Dedaj, z. Brahim Mehmeti, znj. Njomza Grabanica, z. Skënder Merturi, znj. Florinda Gashi.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Gashi, e venë në miratim këtë komision të propozuar dhe me 21 vota PËR, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, MIRATOHET.

Pika e 8. E Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Propozimit për Formimin e Komisionit vlerësues-ad hoc për ndarje të bursave për studentet e Komunës së Klinës (ref.drejtorja e Arsimit).

Në këtë pikë të Rendit të Ditës, kalohet direkt në propozime. Me propozimin e asamblistëve dhe me dakordimin e kryesuesit, nuk debatohet fare përveç kërkesës së kryesuesit që ky komision i ri të punoi seriozisht dhe të mos vonohet. Gjithashtu shpjegohet se ky komision përbëhet nga 5 anëtarë: 2 nga Kuvendi, 2 nga Ekzekutivi dhe 1 nga Shoqëria civile.

U propozuan: z. Enver Berisha, z. Xhevgjet Berisha, z. Hekuran Sejdiu, z. Ahmet Krasniqi, OJQ.

z. Enver Berisha: Kërkoj që qysh sot të merremi vesh se kush me qenë kryesues i këtij Komisioni.

z. Hekuran Sejdiu, drejtor i Shëndetësisë: Propozoi që kryesues i këtij Komisioni të jetë nga Kuvendi, z. Enver Berisha.

Kryesuesi e venë në miratim komisionin e propozuar dhe me 20 vota PËR Asnjë kundër dhe asnjë abstenim, MIRATOHET. (anëtarja e kuvendit, znj. Shqipnora Dauti, nuk merr pjesë fare në votim)

Pika e 9. E Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimi për marrjen e iniciativës për plotësim-ndryshim të rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve.

Kryesuesi i Kuvendit thekson se gjatë shqyrtimeve, kemi : a) Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e një komisioni që do ta bëjë hartimin e kësaj rregulloreje, dhe b) Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për pezullimin e zbatimit të dispozitës, neni 10 paragrafi 1 dhe 2. Tani gjatë seancës. Duke e falënderuar komandantin e Policisë e morra edhe konfirmimin nga Prokurori.

z. Enver Berisha: Ne jemi që të fillohet me ndryshimin dhe plotësimin e kësaj rregulloreje dhe propozoi që menjëherë të fillojmë me propozimet e emrave për anëtarë.

z. Valmir Bacaj: Para se të propozoj anëtarin e Komisionit, qëndrimi grupit tonë kuvendarë është që edhe të pezullohet zbatimi i dispozitës, neni 10 paragrafi 1 dhe 2 si dhe të ndryshohet dhe plotësohet rregullorja në fjalë pasi që Klina është në sy të keq për funksionimin e këtyre lokaleve gjatë natës, ka qenë edhe në media. Prandaj është urgjente të miratohen nga ne sot të dy këto propozim-vendime.

U propozuan 5 anëtarë: z. Besart Hoti, znj. Saranda Zeqa, z. Petrit Palushaj, z. Tush dedaj, z. Zenel Haliti(nga Policia), z. Burim Hoti(nga Inspektorati)dhe zyra ligjore.

Kryesuesi i Kuvendit e venë në miratim Komisionin e propozuar dhe me 21 vota PËR, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, MIRATOHET.

Në fund të kësaj pike të Rendit të Ditës, kryesuesi thekson se është edhe propozim-vendimi për pezullimin e dispozitës neni 10, paragrafi 1 dhe 2. Shpjegon se ky pezullim vlen deri në miratimin e rregullores së re, për hartimin e të cilës u formua Komisioni paraprakisht. Po ashtu shpjegon se ky pezullim nuk mund të futet në fuqi derisa të konfirmohet ligjshmëria e tij nga Ministria adekuate.

z. Gjokë Lleshaj: A mund ta dimë se çfarë thotë neni 10 bashkë me dy paragrafët në fjalë?


z. Fadil Gashi, kryesues: Neni 10, paragrafi 1 dhe 2 i dispozitës thotë se Orari i punës për kafe-bare, disko klube...fillon në orën 20:00 dhe mbaron në orën 3:00 të mëngjesit. Paragrafi 2 thotë se orari i punës për klubet e natës është i njëjtë për dy sezonet, fillon nga ora 23 dhe përfundon në orën 5 të mëngjesit. Ndërsa propozimi është ndryshimi nga ora 22 deri në orën 24. Unë propozoj që fillimisht ta bëjmë pezullimin por mos të implementohet deri në marrjen e përgjigjes për ligjshmëri pasi që kam disa dilema. Mendoj që nuk jemi shumë konform ligjit, sepse rregullorja mund të ndryshohet vetëm me rregullore dhe jo me vendim. Për shkak të rrethanave është mirë që të kaloj ky pezullim. A jeni dakord që të pezullojmë vetëm nenin 10 paragrafin 1 dhe 2? Kush është PËR?

Me 21 vota PËR, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, MIRATOHET.

Kryesuesi i Kuvendit. Fadil Gashi, me përfundimin e pikës së 9 të rendit të ditës, duke i falënderuar të gjithë për kontributin e dhënë në shqyrtime dhe debate dhe duke ju uruar të gjithë anëtarëve të Kuvendit e përmes tyre edhe gjithë qytetarëve shqiptarë të besimit Mysliman, Festen e Filtër Bajramit, i mbyll punimet e seancës së V-të.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj



Kryesuesi i Kuvendit

Fadil Gashi

